

Nr.20

ISSN 2521-831X

BULETINI MUJOR KLIMATIK

Gusht 2018

Universiteti Politeknik i Tiranës

Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit & Mjedisit

Tirana © 2018





BULETINI MUJOR KLIMATIK

Gusht 2018

Nr. 20

Përmbledhje. Muaji Gusht shënoi për stinën e verës 2018 në fakt vlerat më të larta të temperaturave të ajrit. Ai u karakterizua me temperatura mesatare të ajrit me vlera mbi normë me rreth $+2.5^{\circ}\text{C}$ si dhe me vranësira të pranishme në shumicën e ditëve. Nuk munguan reshjet me vlera rreth normës. Rrufetë ishin të pranishme dhe shoqëruese të zhvillimeve konvektive vertikale, në mjaft raste me natyrë lokale dhe reshje. Temperaturat e ujit në sipërfaqe të deteve Adriatik dhe Jon shënuan vlerat më të larta si dhe patën një shmangie deri $+3^{\circ}\text{C}$ kundrejt dekadave të shkuara.

Summary. The month of August marked the summer of 2018 in fact the highest values of air temperatures. It was characterized by an average air temperature of over $+2.5^{\circ}\text{C}$, as well as with clouds present at most of the days. The rainfall values get around the norm. Lightning has been present and associated with vertical convective developments, in many cases of local nature and precipitation. The water temperatures on the Adriatic and Ionian seas were the highest and had a deviation of up to $+3^{\circ}\text{C}$ over the past decades.

SITUATA SINOPTIKE



Ashtu si edhe në muajin e kaluar (korrik), në shumicën e ditëve konveksioni i pasditeve ka qenë i pranishëm në të gjithë zonat kodrinore-malore të vendit (edhe në ato të bregdetit të Jonit). Në vetëm pak ditë ky konveksion ka qenë i pranishëm edhe në vijën bregdetare të Adriatikut. Do të veçonim këto periudha:

Datat 16-19 gusht 2018. Një vijë instabiliteti ndikoi Mesdheun Qendror (shih figurën Nr.1). Ajo u shtri deri në jug-perëndim të vendit tonë, duke shërbyer si një faktor shtesë mbi atë të konveksionit të pasdites.

Figura Nr.1 - Situata sinoptike e datës 16 gusht 2018, 12:00 UTC.

Datat 19-22 gusht 2018.

Në këto ditë një instabilitet i theksuar u krijua (shih figurën Nr.2). Më konkretisht, në sipërfaqen 500 hPa ka pasur disa zona me vlera të ulëta të mbivendosura mbi shtresa të ulëta të atmosferës shumë të lagështa, bashkuar me një fushë të erës shumë të dobët, krijonte kushte për shtrëngata me kohëzgjatje relativisht të gjatë, por me intensitete jo shumë të larta. Faktori kryesor për shtrëngata



herët në mëngjes dhe në mbrëmje vonë (data: 21), për shkak të disa maksimumeve në fushën e “vorticitetit”, të cilat i ofruan masave ajrore të paqëndrueshme një mundësi për t’u ngritur në lartësi. Si rezultat, fenomenet me erë të fortë momentale dhe breshër ishin të pranishme, por të pakta në numër.

Figura Nr.2. - Situata sinoptike e datës 19 gusht 2018, 12:00 UTC.

Datat 24-27 gusht 2018.

Në këto ditë në sipërfaqen 500 hPa një kreshtë do të forcohej mbi Evropën Perëndimore, ndërkohë që në Evropën Jug-Lindore do të ndikonte një zonë e gjerë me vlera të ulëta. Në sipërfaqen e tokës kjo do të manifestohej me 2 vija instabiliteti, që qartazi rrethojnë vendin tonë (shih figurën Nr.3).

Figura Nr.3. - Situata sinoptike e datës 27 gusht 2018, 12:00 UTC.





Figura Nr.4. - Pamje nga vranësirat pranë vijës bregdetare që ishin të shpeshta në orës e pasditeve gjatë muajit gusht 2018 (Foto e datës: 19 gusht 2018, Durrës).

KARAKTERISTIKAT KRYESORE METEOROLOGJIKE TË MUAJIT: GUSHT 2018 DHE DISA KONSIDERATA MBI NDRYSHIMET KLIMATIKE

TEMPERTAURAT E AJRIT – gjatë muajit gusht 2018, shënuan vlera mbi normë pothuajse në të gjithë territorin e vendit tonë me afro **+2.5°C**. Në figurën Nr. 5 dhe Nr.7/1÷7/12 paraqiten të dhënat e temperaturës mesatare të ajrit të përzgjedhura për 33 vendmatje meteorologjike nga zonat dhe nënzonat e ndryshme klimatike të vendit tonë.




Figura Nr. 5– Vlerat mesatare të temperaturës së ajrit për muajin gusht 2018 për disa vendmatje meteorologjike si dhe vlerat përkatëse të normës 1961÷1990 shoqëruar me diferencat përkatëse.

Ndërsa, në shkallë kontinentale vlerat e temperaturave mesatare të ajrit për muajin gusht 2018 paraqitet në figurën Nr. 6, ku jepen dhe anomalitë krahasuar me periudhën 1981÷2010.
















Figura Nr. 6. – Vlerat e temperaturës mesatare të ajrit për muajin gusht 2018 për kontinentin Europian dhe anomalitë përkatëse ndaj periudhës shumëvjeçare 1981÷2010, sipas NOAA-s.

Në mënyrë më të detajuar në figurën Nr. 8 jepen këto anomali të temperaturave mesatare të ajrit për disa javë duke evidentuar vlera të larta mbi normë për pjesën qendrore të kontinentit në javën e parë dhe një situatë të kundërt në javën e fundit, ndërkohë që për vendin tonë u vërtetuan vlera lehtësisht mbi normë me ndryshime të vogla gjatë javëve.

Ndërkohë, temperaturat maksimale të ajrit edhe gjatë muajit gusht 2018 vijuan të ruajnë një tendencë të lehtë (ashtu si dhe në muajin e mëparshëm - korrik 2018) me shmangie vlerash mbi normë **+2.9°C**, më të lartë se ato të vlerave minimale, të cilat paraqiten në figurën Nr.9.

Vlerësime për ecurinë e temperaturës së ajrit dhe reshjet (figurat në vijim Nr. 7/1÷7/12) në disa prej vendmatjeve meteorologjike të Sistemit Kombëtar të Monitorimit Meteorologjik për muajin: Gusht 2018.






Figura Nr. 8. - Anomalitë në vlerat e temperaturave mesatare të ajrit për kontinentin European për disa nga javët e muajit gusht 2018, sipas NOAA-s.




Figura Nr. 9. – Vlerat mesatare të temperaturës maksimale të ajrit për muajin gusht 2018 për disa vendmatje meteorologjike si dhe vlerat përkatëse të normës.

Situata e temperaturave maksimale të ajrit në shkallë kontinentale jepet në figurën Nr.10, ku dallon gadishulli Iberik me temperatura ekstremisht të larta, të cilat ndikuan dhe për një seri zjarresh gjatë këtij muaji në këto hapësira të kontinentit European.




Figura Nr.10. – Vlerat mesatare të temperaturave maksimale të ajrit për kontinentin Europian për disa nga javët e muajit gusht 2018, sipas NOAA-s.

Sa i takon treguesit klimatik të numrit të ditëve me temperaturë mbi pragu 35.0°C , për vendmatjen meteorologjike të Tiranës, ndryshe nga muaji i mëparshëm korrik ku nuk pati ditë të tilla, ai për muajin gusht 2018 shënoi vlera më shumë se dyfishi i normës. Të dhënat paraqiten në figurën Nr. 11.




Figura Nr. 11. – Të dhënat e numrit të ditëve me temperatura të ajrit mbi pragu 35.0°C për muajin gusht 2018 për vendmatjen meteorologjike të Tiranës.

Gjithesesi me vlera mbi normë, por më të moderuara me vetëm **+2.0°C** temperaturat minimale ruajtën këto nivele gjatë muajit gusht 2018 në pjesën më të madhe të vendmatjeve meteorologjike që u analizuan. Në figurën Nr. 12 jepet një tablo grafike për disa nga vendmatjet meteorologjike të përzgjedhura për këtë muaj.




Figura Nr. 12. – Vlerat mesatare të temperaturës minimale të ajrit për muajin gusht 2018 për disa vendmatje meteorologjike si dhe vlerat përkatëse të normës.

NETËT TROPIKALE Netët tropikale (netët kur temperatura minimale e ajrit nuk zbret nën prapun 20.0°C) gjatë muajit gusht 2018 për vendmatjen meteorologjike të Tiranës ishin të pranishme gjatë gjithë muajit. Një muaj i ngashëm në të shkuarën i takon vitit 2009. Në figurën Nr. 13 jepet një pasqyrë e këtij treguesi për vitet e fundit dhe vlerat përkatëse të normës.




Figura Nr. 13. – Numri i netëve tropikale për muajin gusht, për vitet 2002 deri 2018, për vendmatjen meteorologjike të Tiranës si dhe vlerat e normës.

Një analizë më e detajuar për stinën e verës u krye duke ju referuar të dhënave për vendmatjen meteorologjike të Tiranës, paraqitur në figurën Nr.14, ku jepet numri i netëve tropikale sipas muajve qershor, korrik dhe gusht si dhe vlerat e normës (treguar me ngjyrë jeshile).




Figura Nr.14. - Numri i netëve tropikale për muajt e verës 2018, për vitet 2012 deri 2018, për vendmatjen meteorologjike të Tiranës si dhe vlerat e normës.

Për stinën e verës në tërësi, për periudhën kohore të viteve nga 2002 deri më 2018 në figurën

Nr.15 jepet një paraqitje grafike e këtij treguesi, i cili evidenton një situatë pak a shumë të qendrueshme të vlerave, që tashmë janë stabilizuar çdo vit duke qëndruar mbi nivelet e normës.





Figura Nr. 15. – Numri i netëve tropikale për stinën e verës për vitet 2002 deri 2018, për vendmatjen meteorologjike të Tiranës si dhe vlerat e normës.

NDRYSHIMET KLIMATIKE Një tregues i rëndësishëm që shqyrton dhe merret në analizë për ndryshimet klimatike është dhe ai që ka të bëjë me vlerësimin e numrit të netëve tropikale ($T_{\min} > 20^{\circ}\text{C}$) i kombinuar me ditët e nxehta ($T_{\max} > 35^{\circ}\text{C}$). Në figurën Nr.16 në vijim jepet një nga vlerësimet prognozë se si ky tregues pritet ta ketë ecurinë e tij në të ardhmen në kontinentin tonë për periudhat 2021÷2050 dhe 2071÷2100 kundrejt asaj të vrojtuar në vitet 1961÷1990.

Figura Nr. 15. - Numri i netëve tropikale ($T_{\min} > 20^{\circ}\text{C}$) i kombinuar me ditët e nxehta ($T_{\max} > 35^{\circ}\text{C}$) në Europë i vlerësuar për periudha të ndryshme kohore.




Ndërkohë, për një ilustrim është vlerësuar ecuria e këtij treguesi për vendmatjen meteorologjike të Tiranës, paraqitur në figurën Nr. 16, i cili dukshëm pasqyron një tendencë rritje dhe përputhje me atë çka pritet për pjesën tjetër të rajonit dhe kontinentit European.




Figura Nr. 16. - Numri i netëve tropikale ($T_{\min} > 20^{\circ}\text{C}$) i kombinuar me ditët e nxehta ($T_{\max} > 35^{\circ}\text{C}$) në Tiranë, i vlerësuar për periudhën 1961÷1990 dhe vitet 2012÷2018.

KLIMA URBANE – Gjatë muajit gusht 2018 për Tiranën ndryshimet e temperaturave me vlerat e normës shënuan një shmange prej $+3.8^{\circ}\text{C}$, gjë që evidenton dhe një herë (krahasuar me shmangiet përkatëse të vendmatjeve të tjera meteorologjike) impaktin që përcjellin ndryshimet klimatike të shoqëruar dhe me një vlerë të shtuar nga efekti i “ishullit urban”.

Figura Nr. 17. – Të dhënat e temperaturës mesatare të ajrit për muajin gusht për vitet 2012÷2018 dhe vlerat e normës referuar periudhës 1961÷1990 për vendmatjen meteorologjike të Tiranës.





RREZATIMI ULTRAVIOLET

Gjatë muajit gusht 2018 treguesi i UV shënoi vlera të mjaft të larta vetëm në fillim të muajit (shih dhe figurën Nr. 19), pasi më pas për shkak dhe të një vranësire më të pranishme në orët e mesditës, përgjithësisht pati vlera më të moderuara. Rrezatimi UV paraqitet mjaft dëmsjellës për lëkurën, sytë e deri në dëmtimin e ADN (figurë Nr.18).

Figura Nr. 18. Pamje skematike e dëmtimit të ADN nga UV.




Figura Nr. 19. - Pamje e vlerës së treguesit UV për datën 5 gusht 2018, ku pjesa më e madhe e vendit është pranë vlerave ekstreme.

RESHJET ATMOSFERIKE

Gjatë muajit gusht 2018 u vrojtuan reshje në mbarë territorin. Për këtë u përpunuan të dhënat e 59 vendmatjeve meteorologjike (ose rreth 42% e tërësisë së vendmatjeve për këtë tregues që ekzistojnë në vendin tonë), të cilat u përzgjedhën nga zonat dhe nënzonat e ndryshme klimatike të vendit dhe pas kontrolleve dhe verifikimeve të nevojshme në përputhje me standartet e OBM janë pasqyruar në vijim në figurën Nr.20 dhe në tabelën Nr.1 të dhënat e reshjeve mujore si dhe krahasimi me vlerat e normës referuar periudhës 1961÷1990.




Figura Nr. 20. – Vlerat e sasisë së reshjeve për muajin gusht 2018 për 58 vendmatje meteorologjike të vendit tonë si dhe vlerat përkatëse të normave referuar periudhës mesatare shumëvjeçare 1961÷1990.




Figura Nr. 21. - Reshjet për muajin gusht në kontinentin European dhe anomalitë kundrejt periudhës 1981-2010, sipas NOAA-s.

Tabela Nr.1. Vlerat e reshjeve për muajin gusht 2018.

Nr.	Stacioni Meteo.	Reshje (mm)	Nr.	Stacioni meteo.	Reshje (mm)
1	Ballsh	54.0	31	Librazhd	12.0
2	Belsh	61.2	32	Liqenas	57.7
3	Bilisht	163.2	33	Llongo	21.3
4	Bogë	26.3	34	Macukull	99.1
5	Brataj	33.0	35	Mashtërkore	21.9
6	Bushat	11.5	36	Narel	42.5
7	Çuke	0.3	37	Nivice	26.0
8	Dajç Bunë	11.1	38	Peqin	17.0
9	Dajç Zadrimë	13.6	39	Petkaj	54.7
10	Dajt Fshat	124.1	40	Petrelë	69.5
11	Dardhe	57.0	41	Petresh	57.3
12	Dushar	97.3	42	Pogradec	8.3
13	Fier	10.4	43	Polom	88.0
14	Fratar	48.1	44	Prrenjas	10.3
15	Fshat Klos	41.0	45	Pukë	45.1
16	Gojan	26.0	46	Qarrishtë	183.0
17	Gorçë e Madhe	77.1	47	Rapsh	69.5
18	Hoshtevë	119.7	48	Rreshen	40.0
19	Hot	25.0	49	Selishtë	71.0
20	Jaronisht	93.0	50	Shëngjergj	50.0
21	Kalimash	6.3	51	Shupenzë	12.0
22	Kallmet	37.0	52	Sinjë	107.1
23	Kardhiq	19.9	53	Stravaj	18.3
24	Konispol	25.0	54	Tirana	30.1
25	Koplik	14.0	55	Topojan	25.1
26	Krahës	39.9	56	Tropojë	52.0
27	Krujë	24.7	57	Ura e Shtrenjtë	105.0
28	Kuç	48.3	58	Vithkuq	25.0
29	Kurbnesh	15.0	59	Zerqan	37.0
30	Lekbibaj	7.2			

Vlerat e reshjeve maksimale 24 orëshe nuk paraqitën vlera rekord dhe as situata problematike. Vlerat e tyre paraqiten në figurën Nr.23 për 58 vendmatje meteorologjike.




Figura Nr. 22. – Vlerat e treguesit të numrit të ditëve me reshje mbi prapun 1.0 mm për muajin gusht 2018 për 58 vendmatje meteorologjike të vendit tonë.




Figura Nr. 23. Reshjet maksimale 24 orëshe për disa vendmatje meteorologjike të Shqipërisë për muajin Gusht 2018.

Rrufetë

Gjatë muajit gusht 2018 vijuan të jenë të pranishme, siç ishin vecanërisht dhe në korrik duke shoqëruar reshjet me natyrë lokale në mjaft raste dhe karakteristikat e motit në përgjithësi, kryesisht në orët e pasdites në mbarë vendin. Në shkallë kontinentale ato vijuan të jenë të pranishme me një numër të madh pothuajse çdo ditë në nivel të 300 deri 400 mijë shkarkimeve elektrike në ditë.




Figura Nr. 24 – Numri i rrufeve të vrojtuar në pjesën L e JL të kryeqytetit kryesisht pranë zonës kodrinore dhe malore më datë 6 gusht 2018, të vrojtuar në 3 orët që paraprijnë orën 14:00.

STUHITË - Muaji gusht 2018 u karakterizua nga një numër i mesatar i stuhive sipas qendrës eksperimentale të monitorimit dhe parashikimit europian ESTOFEX. Në figurën në vijim Nr. 25 jepet një paraqitje grafike e tyre duke përfshirë të gjithë muajt gusht të viteve 2006 deri më 2018.

jë situatë e veçantë stuhie që preku me periferinë saj dhe një pjesë të vendit tonë, i takon datës 26 gusht 2018. Ajo pasqyrohet në figurën në vijim Nr. 26.




Figura Nr.25. Numri i stuhive të kategorisë 2, sipas viteve për muajin gusht, referuar sistemit ESTOFEX.




Figura Nr.26. Situata e pritshme për stuhitë të kategorive 1, 2 dhe 3 e vlerësuar më datë 26 gusht 2018 për dy ditët në vijim në kontinentin Europian.

DETET ADRIATIK DHE JON

Masat ujore të Deteve Adriatik dhe Jon si dhe ato liqenore përgjithësisht vlerat maksimale të temperaturave sa i takon ecurisë vjetore i shënojnë pikërisht në muajin gusht. Në vitet 1950÷1970 temperaturat në ujërat e Deteve Adriatik e Jon ishin në nivele 22÷24°C (sipas publikimeve të Akademisë së Shkencave – Institutit Hidrometeorologjik) për muajin gusht. Gjithsesi duhet



thënë paraprakisht se në vitet e fundit janë vërtetuar vlera mbi normë, të cilat herë pas herë kanë qenë rekorde dhe natyrisht kanë përcjellë dhe impakte të caktuara. Në vijim jepet harta e temperaturave mesatare në sipërfaqe të ujit në Detet Adriatik & Jon për datën 5 gusht 2018.

Figura Nr. 27. - Pamje nga deti Adriatik në Durrës, më 18 gusht 2018.

Temperaturat në sipërfaqe të ujit në ditët e para të muajit gusht 2018 shënojnë vlera 28÷30°C përgjatë brigjeve të Friulit, Venetos dhe lagunës së Grados në Venecia – Itali, si dhe zonën e Istrias në Kroaci. Pjesa qendrore e Adriatikut si dhe në veçanti ajo e Barit në Itali evidentuan zonat me temperatura më të larta 29÷30°C. Në tërësi deti Adriatik pati vlera mbi 28°C. Për më shumë shih dhe figurën Nr. 28.




Figura Nr. 28. – Temperatura e sipërfaqes së ujit në Detin Adriatik e parashikuar për datën 5 gusht 2018 (sipas Sistemit të Parashikimit të Adriatikut).

Gjatë muajit gusht 2018 anomalitë e temperaturave të ujit në sipërfaqe shënojnë një devijim prej **+3°C** mesatarisht ose dhe më shumë, pothuajse në të gjithë hapësirën e Adriatikut duke përcjellë dhe një shkallë më të lartë të avullimit. Për pasojë masat e ajrit që kalojnë mbi këto hapësira pasurohen më tej me më shumë avuj uji, duke rritur ashpërsinë e stuhive që mund të priten në pjesën kontinentale. Impaktet e vërtetuara në faunën detare paraqiten në figurën Nr. 33.





Figura Nr. 29. – Anomalitë e temperaturës së sipërfaqes së ujit në Detin Adriatik, të parashikuara për datën 5 gusht 2018 (sipas Sistemit të Parashikimit të Adriatikut).

Figura Nr. 30. – Anomalitë e temperaturës së sipërfaqes së ujit në Detin Adriatik pranë grykëderdhjes së Bunës e Drinit.



Një situatë disi e veçantë paraqitet në figurën Nr.30 pranë grykëderdhjes së ujërave të lumenjve Bunë e Drin në Detin Adriatik, me një anomali negative prej deri **-3°C**; e cila është rrjedhojë e prurjes së ujërave të lumenjve në fjalë, të cilët kanë temperatura më të ulta. Kjo situatë lidhet si me shkarkimet nga rezervuarët e hidrocentraleve ashtu dhe reshjet e rëna në zonat e larta të këtyre baseneve.

Reshjet - Në vijim jepen disa vlerësime afatmesme dhe afatgjata mbi kushtet e pritshme meteorologjike mbi hapësirën e kontinentit European, të cilat evidentojnë se për periudhat tre mujore dhjetor 2018 – janar, shkurt 2019, sa i takon regjimit të reshjeve ato do të vijnë në një tendencë me vlera pranë normës ose paksa mbi të për pjesën veriore, kur është fjala për vendin tonë (shih dhe figurën Nr.31), ndërsa temperaturat e paraqesin këtë shmangie të pritshme për zonën jugore (shih figurën Nr. 32).




Figura Nr.31. – Parashikimi i probabiliteteve për reshjet atmosferike për muajt:
Dhjetor 2018 – Janar, Shkurt 2019.





Figura Nr.32. - Parashikimi i probabiliteteve për temperaturat e ajrit për muajt:
Dhjetor 2018 – Janar, Shkurt 2019.

Delfinët Më datë 6 gusht 2018, sipas burimeve të ndryshme mediatike (RAI News, rrjetet sociale, etj..) u vërtetua prania e delfinëve në detin Adriatik, të cilët u panë jo vetëm në Durrës, por ata mbërritën deri në skajin më verior, në gjirin e Triestes. Prania e tyre ishte vënë re për herë të parë në vitin 2009 dhe më pas në vitin 2016.

Figura Nr.33. – Pamje nga prania e delfinëve në gjirin e Triestes më datë 6 gusht 2018.

Referuar të dhënave më të fundit shkencore, si pasojë e ndryshimeve klimatike, flora dhe fauna në tokë po zhvendoset gjithnjë e më shumë drejt gjerësive gjeografike më veriore apo më në lartësi; ndërsa në dete fauna detare po ashtu në vitet e fundit, duke qenë se masat ujore po bëhen gjithnjë e më të ngrohta (shih dhe figurat Nr. 28 dhe 29) ka mundur që shumë specie të lëvizin dhe zhvendosen (natyrisht me shpejtësi të ndryshme) drejt veriut (figura Nr. 34).

Figura Nr.34. Paraqiten shpejtësitë e zhvendosjes për lloje të ndryshme të faunës detare drejt veriut.




Një mister në Mezosferë

- Gjatë kësaj vere diçka jo e zakonshme u vërtetua në shtresën e Mezosferës. Mezosfera është një shtresë e atmosferës që shtrihet nga 50 deri në 80 km lartësi nga sipërfaqja e Tokës. Në këtë pjesë të atmosferës u vërtetua një rritje e përmbajtjes së avujve të ujit. Masat e avujve të ujit kanë arritur deri në këto lartësi dhe kanë përfunduar rreth grimcave të "tymit" të meteorëve. Kësisoj janë krijuar kristale akulli, të cilat kanë formuar retë "noctilucent" (NLCs), të cilat janë vërtetuar me

ngjyra të ndezura në qiellin e natës në gjerësitë e larta gjeografike. Por, misteriozja nuk është kjo. Ajo konsiston në faktin që këto re në muajin korrik të shkonin drejt shuarjes, ndërkohë që ndodhi që ato të arrinin kulmin dhe të vijonin dhe në muajin gusht kur ato u trefishuan kundrejt së njëjtës periudhë më 2017. Sipas të dhënave satelitore të NASA-s muajt korrik dhe gusht 2018 ishin ato me më shumë lagështi në Mezosferë referuar 11 viteve të fundit (figura Nr.35).

Figura Nr.35. Paraqiten me vijë të kuqe nivelet e përmbajtjes së ujit në Mezosferë për muajt korrik dhe gusht 2018.



Për të lexuar buletinet e tjera jeni të mirëpritur të vizitoni faqen përkatëse, duke klikuar në link-un e IGJEUM-it.

To read the other bulletins you are welcome to visit the respective web site, by clicking on the link of IGEWE.



<http://www.geo.edu.al>

Editorial Board:

Prof.Dr. Petrit ZORBA - Head of the Department of Climate and Environment UPT – IGEWE

Prof.Dr. Sylë TAHIRSYLAJ - University of Prishtina – Republic of Kosova.

Dr. Elvin ÇOMO - Member of the Department of Climate and Environment UPT – IGEWE

Subject Editors (Co-Editors):

Dr. Entela Gavroçi, Institute of Applied Nuclear Physics, Tirana University, Albania.

External Reviewers:

Dr. José A. GUIJARRO - AEMET – Madrid, Spain.

Editorial Board approved by the Director of IGEWE – Prof.Assoc.Dr. Fatos HOXHAI

Ky buletín u realizua me kontributin e punonjësve të Departamentit të Klimës & Mjedisit të IGJEUM sipas rubrikave si vijon:

This bulletin has been realized by the staff contribution of the Department of Climate & Environment by rubrics as follow:

Data digitalization: Dr. A. Hasimi, Dr. E. Çomo, Dr. A. Bardhi, Ing. A. Gjoni & St. of UPT Msc. V. Dervishaj.

Data control, verification and elaboration by appropriate software: Prof. P. Zorba, Ing. A. Gjoni.

Evaluation of monthly synoptic situation: M.Sc. M. Marku.

Evaluation of monthly meteorological characteristics and climate change: Prof. P. Zorba.

Scientific information related to some natural phenomena of August 2018: Prof. P. Zorba.



“Buletin Mujor Klimatik”
Departamenti i Klimës dhe Mjedisit
IGJEUM-UPT.
Tiranë © 2018.

